VENDIM
Nr. 522, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 371, DATË 11.6.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR DORËZIMIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME DHE TË DOKUMENTIT TË DORËZIMIT TË TYRE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 26, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Mbetje të rrezikshme klasifikohen mbetjet e shënuara me shenjën yll "*", të miratuara me vendimin nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve".".

2. Në pikën 3, fjalët "... vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve" ..." zëvendësohen me "... vendimin nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve" ...".

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Dorëzuesi, për çdo transfertë, i dërgon elektronikisht nga një kopje të dokumenteve të dorëzimit të plotësuar e të nënshkruar elektronikisht nga palët Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*.".

4. Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"20. Dokumenti i dorëzimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas paraqitjes së kërkesës në mënyrë elektronike nga dorëzuesi. Agjencia Kombëtare e Mjedisit shqyrton kërkesën dhe verifikon të dhënat e kërkuesit nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe licencën III.2.B. Në rast se nga verifikimi konstatohet se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar *e-Albania*, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit e të pasaktësive të konstatuara brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga dita e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës së ndarë elektronikisht përmes portalit unik qeveritar *e-Albania*. Kërkuesi njoftohet përmes portalit unik qeveritar *e-Albania* për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet elektronikisht.".

5. Në pikën 21, togfjalëshi "...10 (dhjetë) ditëve pune ..." zëvendësohet me "... 5 (pesë) ditëve pune ...".

6. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"24. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe administron një bazë të dhënash për kodet unike. Baza e të dhënave shërben si pjesë e Regjistrit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme, që mban Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Baza e të dhënave për kodet unike përmban elementet e mëposhtme:

a) Institucionin administrues, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

b) Të dhënat parësore, si: lloji i mbetjes, kodi i mbetjes sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, gjendja/forma fizike e mbetjes (e gaztë/e lëngët/ngurtë/pluhur/llum/përzier);

c) Të dhënat dytësore, si numri i regjistrimit, NIPT-i, numri i identifikimit të lejes së mjedisit, numri i identifikimit të licencës III.2.B;

ç) Dhënësit e informacionit, si personi fizik/juridik, QKB-ja;

d) Ndërveprimi QKB - Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

dh) Personat e interesuar, si personi fizik/juridik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit."

7. Pas pikës 25 shtohet pika 25/1, me këtë përmbajtje:

"25/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dokumenti i dorëzimit depozitohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama